



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:240855  
Datë: 13.12.2024  
Numri i dokumentit: 06593902

**2023:240856**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, si dhe bashkëpunëtorja profesionale Fitore Hasani – Ismaili, ne çështjen juridiko-kontestimore të paditëses L.H nga Ferizaj me nr. personal ....., të cilën e përfaqëson av. Zejnije Bega Berisha nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizajt-DKA, me objekt kontesti kompensim për orë shtesë, jashtë seance, me datë 13.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Konsiderohet e tërhequr** padia me shenjën 2023:240856, e paditëses L.H, kundër të paditurës Komuna Ferizajt-DKA, me objekt kontesti kompensim për orë shtesë.

**A r s y e t i m**

Paditësja të cilën e përfaqëson av. Zejnije Bega me datë 08.11.2023 ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim për orë shtesë.

Me nenin 253, par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se “në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Përfaqësuesja e paditësit av. Zejnije Bega e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës për padi sipas vërejtjes për taksë të datës 27.03.2024, edhe atë bazuar në flete kthesën e datës 29.03.2024, duke marr parasysh faktin se as pas vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për padi të dërguar nga gjykata, paditësja nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagimit të së njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 253, par. 5 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**2023:240856 datë 13.12.2024**

**Gjyqtari**

**Armend Ahmeti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.